



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 11.12.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të komisionit.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 datë 10.04.2018 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

**Të ftuar:**

Flori Karaj- inspektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Evgjeni Bashari- inspektore në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Erisa Proko- drejtore kabinetit në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Gianluigi Pratola- ekspert ndërkombëtar në EURALIUS

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Kuorumi plotësohet për të vazhduar me çështjen e rendit të ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës sot kemi miratimin e procesverbaleve të komisionit, besoj jeni dakord.

Gjithashtu në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2018 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Kjo është nismë e deputetes Klotilda Bushka. Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore do të jetë kolegja Vasilika Hysa.

Nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Flori Karaj, inspektor, zonja Evgjëni Bashari, inspektore, dhe zonja Erisa Proko, drejtore kabineti. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga misioni EURALIUS Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar.

Faleminderit për pjesëmarrjen në komision!

Pa humbur kohë dua t’ia kaloj fjalën zonjës Bushka për të bërë një prezantim të këtyre ndryshimeve që ajo kërkon t’i bëjnë ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2018 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Ashtu siç jeni vënë në dijeni edhe ju kolegë të komisionit, në kuadër të rritjes së efeciencës së punës së inspektoratit të lartë të deklarimit të pasurive, në kuadër të hetimeve administrative, për sa i takon pasurisë dhe interesave personale të të gjithë zyrtarëve, është e nevojshme që edhe mjetet e punës së këtij institucioni të përmirësohen duke iu përshtatur standardeve më të mira që aplikohen sot në botë.

Inspektorati ka bashkëpunuar me USAID-in, me Këshillin e Europës, me Bashkimin European dhe me projekte të ndryshme të *horizontal facility* në bazë të të cilave, duke iu referuar edhe ndryshimeve që iu bënë ligjit në vitin 2017, ka lindur nevoja e krijimit të një sistemi elektronik për deklarimin e interesave private të zyrtarëve. Ky deklarim elektronik është më se i nevojshëm jo vetëm për rritjen e performancës në drejtim të cilësisë dhe të

sqarimit të të dhënave që deklarohen, por edhe në drejtim të transparencës dhe të bërjes publike të këtyre të dhënave të aksesueshme nga grupet e interesuara.

Në kuadër të reformës në drejtësi, ligji, për të cilin unë kam propozuar disa ndryshime sot, ka ndryshuar, duke u futur për herë të parë edhe mënyra e deklarimit *online*, por në ligj mungojnë çelësat që ky sistem elektronik *online* të jetë efektiv, sepse parashikimet në ligjin aktual nuk janë të plota dhe është e nevojshme që të prezantohen, siç bëjmë në nismë, në mënyrë që ky sistem, duke qenë se nga informacioni që kemi nga të gjithë partnerët e ILDKPI-së dhe nga vetë institucioni që puna ka ecur mirë për sa i takon hartimit dhe projektimit të një sistemi *online*, i cili mendohet të pilotohet për t'u zbatuar edhe më parë sesa afati i parashikuar në ligj. Ky është një hap përpara, i vlerësuar edhe në raportprogresin për Shqipërinë dhe një detyrë e lënë nga raportprogresi, që procesi i deklarimit dhe i kontrollit *online* të interesave të zyrtarëve duhet të bëhet më shpejt, pasi është një faktor për nxitjen e një kontrolli më të plotë që i shërben edhe përgjegjshmërisë më të lartë të institucionit të transparencës dhe forcimit të punës. Kështu që në konsultim me partnerët ndërkombëtarë të institucionit, si dhe me institucionin kemi paraqitur ndryshimet në ligj, të cilat konsistojnë në hapjen e rrugës ligjore që inspektorati jo vetëm ta ngrejë sistemin, por ta ketë atë efektiv nëpërmjet pilotimit si fazë e parë dhe më pas nëpërmjet vënies në zbatim në tërësi më shpejt sesa parashikimi i bërë në strategjitë apo në legjislationin e mëparshëm, në mënyrë që të përmbushim një nga detyrimet kryesore që kemi në kuadër të procesit të integritetit me Bashkimin Europian, që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit dhe marrjen e masave për hetime të plota dhe të gjithanshme, të cilat japin rezultate më shpejt, por edhe në kuadër të shtyllës përkatëse në strategjinë e reformës së drejtësisë, që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit dhe masat kundër krimit të organizuar.

Të gjitha këto kanë qenë interesat dhe baza mbi të cilën janë paraqitur ndryshimet. Zonja Hysi, relatorja, besoj se do t'i sqarojë më qartë. Është punuar ngushtësisht me partnerët ndërkombëtarë të Inspektoratit për të parë nëse përputhem dhe jemi në balancë me atë që kërkohet si detyrim për Shqipërinë dhe me harmonizimin e këtyre detyrimeve me të drejtën aktuale në fuqi, si dhe për efekt të faktit se ligji për deklarimin e pasurive është një ligj i ndryshuar në kuadër të reformës në drejtësi në vitin 2017, ku kemi kërkuar bashkëpunimin me EURALIUS për të vlerësuar nëse propozimet e sjella me këtë nismë kanë implikime me gjithçka që është arritur në kuadër të reformës në drejtësi, sepse për ne është thelbësore të mos preket asgjë që është ndryshuar në ligjin aktual për t'u përputhur me detyrimet që kemi pasur në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi. Kështu që bashkë me ato që do të prezantojë zonja Hysi, unë mendoj se e ezaurova pjesën e prezantimit të nismës, ku falënderoj edhe kolegët për mbështetjen. Nëse ka pyetje ne jemi të gatshëm për t'ju sqaruar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, i cili, sikurse jemi të gjithë në dijeni, ka pësuar ndryshime edhe në kuadër të reformës në drejtësi. I gjithë objekti i ndryshimeve, që propozon kolegja Bushka, është për të përmbushur disa detyrime që ne vetë i kemi marrë në kuadër të strategjive, të planeve të veprimit në luftimin më me efektivitet të korrupsionit, në rritjen e transparencës së institucioneve, në forcimin e ILDKPI-së, por njëkohësisht edhe të një ndryshimi që kemi bërë kohë më parë në ligjin për deklarimin, kontrollin e pasurive e konfliktin e interesave private.

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, unë dua të sjell në vëmendjen tuaj që ILDKPI-ja ka pasur një rol shumë të rëndësishëm për shkak të detyrave të reja që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë u ka dhënë gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të rivlerësimit kalimtar, por edhe të ligjit për sinjalizuesin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Republikën e Shqipërisë.

Me gjithë progresin e bërë, progresraporti i Bashkimit Europian, i bërë publik në vitin 2018, ka nënvizuar se një sistem i deklarimit të asetëve *online* ende nuk është krijuar, ndërkohë që jep një vlerësim të detajuar pozitiv të rolit që ka luajtur ILDKPI-ja në zbulimin e konfliktit të interesit, në kontrollin e deklaratave dhe në angazhimin e saj në rolin që ka në vlerësimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë, por njëkohësisht vlerësojnë edhe faktin që Kuvendi i Shqipërisë ka qenë i kujdesshëm dhe ka rritur kapacitetin e ILDKPI-së dhe mbështetjen financiare të tij, me qëllim që të forcojë kontrollin e deklarimit të asetëve.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, një nga 5 prioritetet që ne duhet të përmbushim në kuadër të integritimit europian është prioriteti i tretë, lufta kundër korrupsionit, ku ka rekomandime lidhur me rolin e verifikimit të asetëve dhe parandalimit të konfliktit të interesave të funksionarëve të lartë.

Së treti, në korrik të vitit 2018 GRECO bëri publik raportin e tij të dytë të përputhshmërisë lidhur me parandalimin e krimit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët. Në këtë raport ILDKPI-ja ka pasur vlerësime pozitive dhe dy rekomandimet që i përkisnin asaj janë vlerësuar si të përmbushura në mënyrë të kënaqshme, por njëkohësisht GRECO nënvizon se mbetet ende punë për t'u bërë për sa i përket krijimit të sistemit *online*, ku do të lejohet hedhja dhe menaxhimi elektronik i këtyre të dhënave. Kjo detyrë është lënë në kuadër të raportit për t'u përmbushur brenda marsit të vitit 2019. Për më tepër, në këtë raport GRECO kërkon njëkohësisht edhe deklaratimet *online* të deklaratave të pasurisë të parlamentarëve, pa pasur nevojë për një kërkesë të mëparshme nga persona të tjerë.

Gjithashtu, strategjia ndërsektorale kundër korrupsionit 2015-2020 dhe plani i veprimit kanë një objektiv që nuk do të doja ta detajoja, pasi kolegia Bushka në relacionin shoqërues të nismës e ka detajuar të gjithë bazën ligjore dhe detyrimet që ka marrë përsipër qeveria shqiptare. Ne jemi angazhuar që në objektivin A5 të forcojmë regjimin e deklarimit të kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë. Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën për vitin 2017 dhe për prioritetet e vitit 2018 i ka lënë si detyrë ILDKPI-së për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, si dhe ka marrë angazhimin për ta mbështetur këtë institucion me financimet e nevojshme për ta përmbushur këtë detyrim. Këto janë disa dokumente strategjike, vendase dhe ndërkombëtare, që tregojnë pse nisma është e dobishme dhe në kohë. Këtu dua të falënderoj kolegen Bushka.

Gjithashtu, ashtu sikurse thuhet qartësisht në relacion, ky proces tashmë ka filluar, pra ka një projekt të USAID-it dhe Këshillit të Europës, por ka dhe donatorë të tjerë, siç është projekti i binjakëzimit, i cili është i angazhuar në këtë proces. Prandaj, pyetjes pse duhet të diskutohet projektligji dhe pse duhet miratuar është pikërisht jo thjesht për të përmbushur rekomandimet ose edhe detyrime që kemi marrë, por, në fund të fundit, është edhe në dobinë tonë dhe të të gjithë funksionarëve të lartë.

Ka ardhur koha të kemi një sistem transparent sa më të thjeshtë dhe sa më të gjurmueshëm të të gjitha transaksioneve dhe veprimeve. Kjo është e mirë edhe për të mbrojtur funksionarin publik që të mos gabojë, por edhe të kontrollojë në mënyrë sistematike çdo lloj transaksioni që mund të rrezikojë integritetin e tij ose ta përfshijë atë në veprimtari me dashje ose pa dashje, që bien ndesh me ligjin. Projektligji ka disa risi, ku shumë shkurt dhe me gjuhë të thjeshtë do të doja t'i theksoja ato.

Së pari, qartësohet detyrimi që mbartin subjektet aktuale, të cilat kanë plotësuar ose kanë dorëzuar më parë deklaratën e interesave private, që do të thotë se të gjithë kandidatët që konkurrojnë për në institucionet e drejtësisë, në momentin e kandidimit ata i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë.

Së dyti, bëhet një qartësim i mënyrës së dorëzimit të deklaratave dhe vënies në funksionim të sistemit elektronik. Pra, nëpërmjet këtij ndryshimi, për herë të parë, në mundësojmë dorëzimin elektronik dhe më pas printimin e deklaratës në një formë shkresore.

Së treti, do të krijohet mundësia që inspektorët e autorizuar nga inspektori i përgjithshëm të adresojnë kërkesa në banka të nivelit të dytë dhe subjektet e tjera për të marrë informacion dhe për të aksesuar të dhëna. Besoj se të gjithë biem dakord për këtë, sepse vetë ne jemi subjekte dhe, nuk ka më mirë që institucioni t'i marrë direkt të gjitha të dhënat, duke mos kërkuar një mori letrash, që shpeshherë për t'i gjetur ato në institucionet shtetërore ose në

institucionet ku ne kemi ofruar shërbime të gjithë funksionarët hasin vështirësi, për shkak të mënyrës sesi menaxhohet dhe sesi mbahet dokumentacioni. Nga ana tjetër, kjo është një mënyrë shumë e mirë për të lehtësuar dhe për të qenë miqësorë me ambientin, për të mos printuar letra dhe për të mos pasur ecejake nëpër institucione të ndryshme, pasi kjo mund të merret direkt nëpërmjet aksesit që jepet në të gjitha institucionet që kanë të dhëna në mënyrë elektronike. Madje këtë të drejtë ne ia kemi dhënë që në ndryshimet e mëparshme që i bëmë ligjit për deklarimin e pasurisë.

Gjithashtu, ne kishim vënë ne dispozitën kalimtare një paragraf që deklarimi *online* nuk mund të bëhet para tre vjetësh dhe jo më vonë se pesë vjet, por çfarë ka ndodhur sot?! Falë mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë: USAID-it, Këshillit të Europës dhe Bashkimit European, ILDKPI-ja i ka përmbushur detyrimet dhe sistemi është gati në përfundim për t'u bërë eficient dhe për t'u marrë në dorëzim nga ILDKPI-ja dhe për të filluar me pilotimin, testimin dhe trajnimin dhe finalizimin e gjithë këtij procesi. Nëse ne nuk do ta bënim këtë ndryshim, nuk mund të fillonte pilotimi dhe testimi i tij, me qëllim për të parë ecurinë e tij, nevojën për axhustime, nëse do të ketë, dhe për trajnimet e gjithë funksionarëve të lartë publikë që janë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave privatë.

Gjithashtu, për herë të parë hapet rruga ligjore për të bërë përmbushjen e deklarimeve *online* për tri kategori: kur deklaron periodikisht, kur deklaron për herë të parë dhe kur largohesh nga detyra, që do të thotë se këto tri lloje deklarimesh do të bëhen në mënyrë elektronike, do të jenë të sintetizuara dhe për ne do të jetë shumë më e lehtë për të plotësuar dhe për t'i ndjekur hap pas hapi të gjitha asetet që secili funksionar publik deklaron.

Unë, në cilësinë e relatores, krahas vlerësimit të projektit, në raport me detyrimet që duhet të përmbushë Kuvendi për sa u përket rekomandimeve të institucioneve të pavarura vendase dhe ndërkombëtare, isha pjesë edhe e konsultimit me misionin EURALIUS dhe me propozuesen. Me këtë rast dua të falënderoj misionin EURALIUS dhe propozuesen për diskutimin tepër konstruktiv që u zhvillua.

Të nderuar kolegë, nga pikëpamja kushtetuese projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nuk ka efekte financiare, besoj se edhe Ministria e Financave e ka dhënë vlerësimin e saj. Nga pikëpamja e përmbajtjes, sikurse shprehet shumë qartë në relacion dhe ky është një relacion i hartuar shumë bukur në tërësinë e tij, duke na dhënë një informacion për çdo lexues, besoj se ne përmbushim të gjitha angazhimet që kemi në kuadër të strategjive kombëtare dhe rekomandimeve të mekanizmave monitorues ndërkombëtarë, duke i përmbushur në kohë dhe me cilësi.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, dua të theksoj që gjatë diskutimit nen për nen ka nevojë për disa përmirësime dhe saktësime, me qëllim që të respektojmë teknikën legjislative.

Me këtë rast më lejoni të propozoj miratimin e këtij ligji në parim dhe kalimin e diskutimit nen për nen. Besoj se të gjithë ju e keni përpara projektin amendament, tekstin integral, ku reflektohen edhe propozimet dhe diskutimet e bëra gjatë ditës së djeshme edhe më parë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

A ka pyetje nga kolegët lidhur me nismën? Jo, nuk ka.

A ka diskutime? Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** –Amendamentet e propozuara në projektligjin që po shqyrtojmë janë thjesht procedurë. Ne bëjmë disa ndryshime procedurale të nevojshme dhe për këtë fakt mbështes iniciatoren dhe mendimet e zonjës Hysi.

Mua më shqetëson diçka. A e dini ju kolegë të dashur se prokuroria nuk pyet fare për denoncimet e këtij institucioni të rëndësishëm?! Unë nuk e di se në ç’raport janë denoncimet që ka bërë ky institucion kaq i rëndësishëm dhe çështjet penale që ka filluar prokuroria. Ndoshta opinioni im është i gabuar, por deri më sot prokuroria është tallur me denoncimet e bëra nga ky institucion.

Ne e kemi ngushtuar të drejtën për fillimin e çështjes penale edhe me Kushtetutë dhe ia kemi veshur një organi, siç është organi i prokurorisë. Nuk e di, ne kontrollojmë?! Pra, ky institucion, i varur nga Kuvendi, kontroll dhe bën shumë mirë, por cili është rezultati? Ne duam të vrasim mendjen, që ky institucion, jo vetëm të kontrollojë, por edhe të evidentojë dhe t’u shkojë gjërave deri në fund.

Unë fola bruto, por, gjithsesi do ta mbështes projektligjin e propozuar, por mendja më mbetet këtu, si duhet forcuar ky institucion, që realisht të kthehet në një institucion efikas?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braho!

A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2018 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar”, nismë e deputetes Klotilda Bushka.

Atëherë, kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të këtij projektligji.

Në formë tabelare përpara keni një variant të integruar, pra një tekst integral, të këtij projektligji. Relatores do t'i kërkoja që ta ndjekë në dinamikë hedhjen në votim të neneve. Ndërkohë, aty ku ka komente dhe sugjerime nga propozuesja, nga relatorja apo edhe nga kolegë deputetë, ju lutem, kërkojeni fjalën!

Zonja Hysi, vazhdojmë me nenin 1.

Kush është dakord me nenin 1, sipas riformulimit të propozuar?

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Kolegë, neni 1 është sipas nismës së koleges Bushka. Meqenëse ligji “Për konfliktin e interesit” mund të jetë objekt i një ndryshimi ose mund të ketë një ligj të ri, bazuar në sugjerimet që kanë bërë qoftë projekti dhe ekspertët e GRECO-s, për të qenë një ligj i qartë dhe transparentë, ne kemi hequr referimet në nenet e ligjit dhe i jemi referuar legjisllacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Pra, është i njëjti tekst me propozuesin, vetëm kemi hequr terminologjinë, nenet përkatëse, sepse mund të ketë një numërtim tjetër neni pas amendimit të tij.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit të paraqitur në tekstin integral? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Janë dy drafte, të lutem, a mund të ma shpjegojë relatorja: njëri është propozimi i zonjës Bushka, besoj se ky...

**Ulsi Manja** – Po.

**Alket Hyseni** – Po, ky drafti tjetër?

**Vasilika Hysi** – Ai është integrali, aty keni ndryshimet.

Pra, kemi bërë gati tabelën për të parë si ishte dhe çfarë propozohet, më pas kemi bërë draftin integral që sugjerohet t'i shkojë seancës. Ky është sugjerimi që na ka bërë vazhdimisht zoti Fino. Pra, kolegu Fino, gjithmonë, ka bërë vërejtje për të pasur një informacion sa më të plotë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Neni 2.

**Vasilika Hysi** – Neni 2 është njësoj sipas variantit të paraqitur.

**Ulsi Manja** – Atëherë, e themi në votim nenin 2.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.



Miratohet neni 2.

Neni 3.

**Vasilika Hysi** – Edhe neni 3 nuk ka ndryshime.

**Ulsi Manja** - Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4.

**Vasilika Hysi** – Në lidhje me nenin 4, shtohet një nen i ri për të rregulluar nenin 7 të deklaramit periodik vjetor, duke hequr referimet në nenet përkatëse të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, por duke iu referuar legjislacionit në fuqi “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionarëve publikë”. Në këtë mënyrë shmangim çdo rikthim për amendim të këtij ligji, ndoshta edhe brenda vitit të ardhshëm. Ne i parandalojmë, duke shmangur rikthimin për të ndryshuar, thjesht për teknikë legjislative, ligjet që janë në fuqi.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Ndoshta këtu duhet një rregullim leksikor, sepse më duket i paformular saktë, në sensin e të kuptuarit. Për shembull, Inpesktoriati i Lartë ta paraqesë personalisht, në formë fizike, të mbyllur në zarf, mendoj se duhet formuluar saktë: “dorëzoi në formë shkresore”, ashtu siç e ka edhe relacioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po le të jetë, ne po e ndryshojmë ligjin. Ky formulim është gabim.

Së pari, mendoj se mund të dorëzohet me postë, sepse njihet.

Së dyti, dorëzim “Në formë fizike”, nuk shkon si term.

**Vasilika Hysi** – “Dorëzimi i formularit”.

**Alket Hyseni** – Por, nuk është e saktë: “është dorëzim në formë shkresore”. Pra, jemi mes dy koncepteve, “plotësimi elektronik” dhe “plotësimi shkresor”. Pra, duhet të ruajmë kuptimin dhe të themi “formë fizike”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Në fakt, nenin 3 e kaluam.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, përfaqësuesit e Inspektoratit, a kanë një sqarim për këtë?

Urdhëroni, zoti Ganaj!

**Flori Karaj** – Në lidhje me ndryshimet që propozohen, pra në cilësinë e përfaqësuesit të ILDKKPI-së së bashku me zonjën Bashari, ne e vlerësojmë iniciativën ligjore lidhur me shtesat dhe ndryshimet e këtij ligji. Pra, kjo që thuhet në nenin 4, deklarimi do të bëhet *online*.

Domethënë, do të plotësohet *online* dhe në Inspektoratin e Lartë, vjen në mënyrë elektronike, por për një kohë të caktuar do të bëhet edhe në mënyrë shkresore. Pra, vetëm do të printohet, jo se do të plotësohet përsëri. Pra, plotësohet një herë në kompjuter, sipas programit, *online*, dhe për një kohë të caktuar, 1, 2 apo 3 vjet, varet si do të ecë procesi, do të printohet. Kjo e printuara do të dërgohet me zarf të mbyllur në Inspektoratin e Lartë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Zoti Inspektor, unë nuk kuptova një gjë: unë do ta bëj *online* dhe nuk e dërgoj fizikisht, a jam në rregull?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne u japim mundësinë të gjitha subjekteve që të bëjnë ose *online*, dhe kjo është kryesorja, ose me zarf, pra u japim mundësi të dyja rasteve: ose ta çoj me zarf, ashtu siç e çoj gjithmonë, ose *online*. Çfarë kuptimi ka kjo?!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Karaj, mund ta sqaroni zotin Fino?!

**Flori Karaj** – Deklarimi do të bëhet *online* për një kohë të caktuar, për shkak të implementimit të projektit, është i nevojshëm, kështu është gjykuar dhe menduar, që kjo mund të bëhet për 1, 2 apo 3 vjet, nuk është se do të shkojë përgjithmonë.

**Bashkim Fino** – Pse e doni edhe fizikisht?

**Ulsi Manja** – Sepse ka lidhje me funksionimin e platformës së komunikimit elektronik.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Kjo nuk ka lidhje, mos na bëni gjëegjëza tani! Unë e kam të shkruar në kompjuter dhe e printoj atje. Ky çfarë po thotë?! Atë që unë e kam *online*, që është në kompjuter, thjesht do të shtyp një print, do ta printoj dhe do ta dërgoj te zyra poshtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, Zoti Karaj, një sqarim!

**Flori Karaj** – Ka edhe një tjetër problem, për firmën dixhitale. Meqenëse nuk është zgjidhur ende, dhe është në proces të zgjedhjes firma dixhitale, dërgimi në mënyrë shkresore, i printuar i kësaj deklarata është edhe për shkak të nënshkrimit. Ka edhe një detyrim për nënshkrim, meqenëse mungon firma dixhitale.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Karaj!

**Bashkim Fino** – Nuk e kuptova. Tani do të miratojmë nen për të qenë korrekt, apo jo? Unë nuk e kuptova. Ky thotë: “Meqenëse në kompjuter nuk vë dot firmën dixhitale...”

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë jam duke bërë ligjin “Për tatimin”, që t’i të jesh funksionar, të punosh. Meqenëse, unë nuk e hedh dot firmën në kompjuter dixhitale, tani më thoni, do të jetë edhe elektronike, edhe ca vjet kështu?! A do të zgjidhet përfundimisht kjo? Po u bë elektronike, është elektronike. Ato që hidhen atje janë me përgjegjësi, sepse ndoshta kjo firmë dixhitale nuk hidhet kurrë, pastaj çfarë do të bëjmë?! Kot që e kemi vënë këtu në nen. Domethënë, të bëjmë një nen që të funksionojë, jo ta bëjmë një nen thjesht të jetë ky nen, më pas shihu pa të piqemi! Pra, nja 2 - 3 vjet ne do të vazhdojmë me formën ekzistuese që kemi, pra e dorëzojmë me zarf, por pas 3-4 vjetësh, kur të dalë kjo, është edhe këtu. Pra kështu thoni?!

**Ulsi Manja** – Unë po ia kaloj fjalën koleges Bushka, por më duket se neni 3, pika 3, e sqaron këtë gjë.

Po zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Unë jam dakord me thelbin, pra në këtë fazë të parë le të jetë elektronikisht, edhe e dorëzuar në formë shkresore, por thjesht isha për terminologjinë që të jemi pak më të saktë.

Së pari, i bie që mijëra zyrtarë të vijnë atje dhe të rreshtohen te protokollin, që është jonormale. E heqim termin “personalisht”, sepse kështu siç e themi do të thotë...

**Ulsi Manja** – Është e saktë.

**Alket Hyseni** – Së dyti, formulimi në “formë fizike” nuk është një formulim as në përputhje me gjithë legjislationin tonë, duhet ta ndryshojmë duke thënë “në formë shkresore”.

**Klotilda Bushka** – Jam dakord.

**Alket Hyseni** – Ky ishte propozimi im, dhe në këtë fazë edhe për shkak të asaj që thotë kryeinspektori të mungesës së firmës dixhitale.

Së dyti, duhet edhe për shkak të protokollimit në sistemin shkresor, dhe kjo për shumë arsye: për arsye të komunikimit me institucione të tjera, hetimit të thelluar e të tjera, deri sa të vijë një moment i dytë, pra pas disa vjetësh e rishikojmë këtë nen.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti Karaj!

**Flori Karaj** – Nuk thuhet: “do ta dërgoj në Inspektoratin e Lartë”, por “në strukturat përkatëse” që janë autoritete përgjegjëse. Autoriteti përgjegjës i Kuvendit, deputetja në institucionet tjera publike, do ta dorëzojë deklaratën personalisht. Ashtu duhet ta dorëzojë, jo në Inspektoratin e Lartë, por në institucionin e autoritetit përgjegjës.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Karaj!

Duhet të reflektohet propozimi i zotit Hyseni, që të shkruhet “formë shkresore”.

**Vasilika Hysi** - Jam dakord.

**Ulsi Manja** – Neni 4.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Përsëri për formulim, në përgjithësi fusim disa nocione, për shembull, “detyrohen”, unë mendoj se “kanë detyrimin”, sepse “detyrohen” duket sikur ia bën me dhunë. Pra, “kanë detyrimin për të paraqitur deklaratat deri më 31 mars”.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Kush është dakord me nenin 4, sipas sugjerimit të bërë nga kolegu Hyseni? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4, sipas tekstit integral dhe sugjerimit të bërë nga zoti Hyseni.

Neni 5.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, në nenin 5 është një nen i shtuar, i cili përpiqet të amendojë nenin 9 të ligjit që është në fuqi “Deklarimi me kërkesë”. Neni 9, pikat 2 dhe 3 të ligjit ekzistues, sugjerohet të ndryshojë. Ky rregullim është thjesht nga teknika legislative. Pra, synon të heqë referencat në nenet përkatëse të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit” apo në ligje të tjera, sepse janë ligje të cilat janë në axhendë për t’u ndryshuar në kuadër të reformës që do të bëhet për rritjen e eficiencës së luftës kundër korrupsionit dhe parandalimit të konfliktit të interesit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush është dakord me nenin 5, sipas sugjerimeve të bëra nga relatorja? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6.

**Vasilika Hysi** – Neni 6 është një nen i ri dhe ndryshon nenin 11 të ligjit në fuqi, ka disa ndryshime që bëhen në këtë nen. Këto ndryshime bëhen duke pasur parasysh edhe ndryshimet që janë bërë në lidhje me ligjet e reformës në drejtësi.

Të nderuar kolegë, shpesh në parlament ne kemi bllokim të institucioneve të pavarura, qofshin ato kushtetuese apo të krijuara me ligj. Është element shumë i rëndësishëm që përzgjedhja e titullarëve të bëhet me një shumicë absolute ose me 3/5, ose siç janë ndryshimet Kushtetutë, me 2/3, por shpesh, siç ndodhi në reformën në drejtësi, kemi pasur bllokim të tyre. Ligji synon të parashikojë një mekanizëm zhbllokues, pasi të ketë pasur disa raunde lidhur me zgjedhjen e titullarëve të institucioneve të pavarura dhe në rastin konkret është parashikuar një mekanizëm zhbllokimi.

Së dyti, ka një ndryshim tjetër lidhur me periudhën, pra mandati do të jetë 7-vjeçar, por nuk do të ketë të drejtë rizgjedhjeje. Gjithashtu, është rregulluar mënyra e teknikës legjislativë dhe është qartësuar procedura se si do të zgjidhet inspektori i Përgjithshëm. Përsëri procesi i garimit është transparent, me kandidatura alternative, me një seancë dëgjimore në parlament. Komisioni që do të shqyrtojë kandidaturat është Komisioni i Çështjeve Ligjore, që është përgjegjës për çështjet ligjore. Në përzgjedhje do të zbatohen rregullat e këtij ligji, por edhe Rregullorja e Kuvendit, duke dërguar në Kuvend të paktën dy kandidatë, sipas procedurës së mësipërme. Pra, ideja është të ketë garë, të ketë një proces transparent, një procedurë të mirëpërcaktuar, si dhe të ketë mekanizëm zhblllokimi që të mos mbetemi pa institucione, siç ka ndodhur në shumë raste.

Gjithashtu, ka një tjetër ndryshim të rëndësishëm, që inspektori i Përgjithshëm bën deklarin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij, si çdo funksionar tjetër, njëkohësisht, i nënshtrohet të gjithë detyrimit që ka, që pas përfundimit të mandatit të tij dhe bërjes së gjithë procedurave, që lidhen qoftë me deklarin e pasurisë, ai të rikthehet në detyrën publike që ka pasur më parë ose në një vend të barazvlefshëm me vendin e mëparshëm. Në këtë kuadër kemi bërë qartësisht të qartë që ai nuk e përfiton këtë privilegj nëse ai shkarkohet për shkak të shkeljes së ligjit apo të akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e inspektorit të Përgjithshëm. Pra, rikthimi në pozicionin e mëparshëm, ashtu siç e kemi bërë edhe për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, për anëtarët e organeve të vetingut dhe çdo institucion tjetër është, i tillë, që mundëson edhe mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë, edhe garancinë që do të vijë kandidatët më të mirë, por, njëkohësisht edhe respektimin e të gjithë kontributit të tyre. Kjo është pjesë e përgjegjshmërisë dhe vlerësimit për të pasur kandidatë sa më të mirë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

A keni pyetje?

Urdhëroni, zonja Xhina!

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Jo, nuk konsiston në pyetje ndërhyrja.

Për sa i përket nenit 11, që thamë se është një risi, ku flitet për inspektorin e Përgjithshëm, kam vërejtje për sa i përket pikës 1, ku thuhet: “Organi përgjegjës për kontrollin e deklarin të pasurive është inspektori i përgjithshëm”. Tani dimë që organi përgjegjës është ILDKPKI-ja, dhe jo inspektorët, mos ndoshta është shprehur gabim. Pra, inspektori i Përgjithshëm konsiderohet organ në këtë nen?

**Vasilika Hysi** – Po.

**Ulsi Manja** – Është organ monokratik dhe në organe monokratike përgjegjësia dhe vendimmarrja është individuale.

**Elena Xhina** – Mendoj se duhet riparë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Karaj!

**Flori Karaj** – Mendoj se përcaktimi në dispozitë është i drejtë, sepse është institucion monokratik dhe vendimmarrja është monokratike.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Në rregull, ashtu e lëmë, por duhet parë edhe në ligje të tjera ku referohet. Si thuhet: “Kontrolli i pasurive kryhet nëpërmjet Inspektoratit të Kontrollit të Lartë, apo inspektorit?”

**Ulsi Manja** – E thotë ligji organik.

Zoti Fino, ka kërkuar fjalën për pyetje.

Urdhëroni!

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Nuk kam komente për këtë nen.

Së pari, nuk më pëlqen që ne duhet të jemi me një standard dhe jo me dy standarde. Domethënë, në qoftë se në ligje të ndryshme kemi vendosur, për shembull, për Guvernatorin e Bankës apo edhe për institucione të tjera kushtetuese dhe jokushtetuese të krijuara me ligj, ku kemi thënë: “Çdo njeri ka të drejtë të kandidojë edhe një herë tjetër”, nuk mendoj se inspektori i Përgjithshëm këtu zgjidhet nga Kuvendi me mandat 7-vjeçar dhe kaq mbaroi. Domethënë, duhet ta rishikojmë në kuadrin e të gjithë ligjeve të tjera që keni: si e keni në ligje të tjera? A kanë të drejtë edhe për një mandat të dytë? Në qoftë se duhet dhe është, atëherë është mirë ta vendosim edhe këtu, meqenëse po bëjmë një rregull të tyre.

Çështja e dytë që kam unë është fakti se më shqetëson pika 8, kryetar. U zgjodh inspektori i Përgjithshëm. Aty thuhet: “Inspektori i Përgjithshëm brenda 30 ditëve deklaron pasurinë e vet dhe ia paraqet Kuvendit të Shqipërisë”. Ç’do të thotë ia paraqet Kuvendit të Shqipërisë? Kush e kontrollon deklarimin e pasurisë së kryeinspektorit? Domethënë, është një institucion që vërtet varet dhe zgjidhet nga ne, por nga pikëpamja teknike dua të pyes edhe relatoren, edhe iniciuesit, por edhe ju si juristë: në qoftë se unë jam kryeinspektori dhe e deklaroj pasurinë, por unë e bëj aktivitetin tim çdo vit, deklarimin e pasurisë do t’ia jap Çdo vit Kuvendit të Shqipërisë? Kush e kontrollon? E kontrollojnë deputetët? Jo. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit? Mua më duket absurde, sepse ai është një subjekt që kontrollohet nga

ILDKPKI-ja. Çfarë do të thotë? Do të thotë një subjekt shumë i vogël në raport me mua që bëj ligjin dhe me ty që bën ligjin, të kontrollojë kryeinspektorin çdo vit, sepse kështu i bie. Pra, mua më shqetëson pika 8. Është normale që duhet ta shikojë Kuvendi, por duhet mekanizmi për ta kontrolluar deklarin e pasurisë së kryeinspektorit. Kjo është shumë e diskutueshme dhe na del jashtë shinave. Kjo do të thotë se nëse ky kryeinspektori kontrollon shumë subjekte, atëherë pasurinë e tij s'mund ta kontrollojë një subjekt më i vogël dhe çdo vit.

E fundit, unë kam qenë gjithmonë kritik dhe kjo pika 9 nuk më pëlqen fare. Zotërinj, ne bëjmë ligj për kryeinspektoratin, ne bëjmë ligj se si do të zgjidhet kryeinspektori, nuk bëjmë ligj se ku do të shkojë kryeinspektori. Turp, turp... Në bëjmë ligj se si do të zgjidhet kryeinspektori, pra nëse do të zgjidhet me konkurrim; nëse do të zgjidhet për 7 vjet apo dy herë nga 7 vjet, do të kontrollohet etj. Ai do të bëjë detyrën e tij kushtetuese. Të bësh në ligj për të drejtën që kryeinspektori të kthehet në punë, atje ku ka qenë më parë, është absurde. E keni bërë këtë edhe në një ligj tjetër, për të cilin isha kundër dhe keni bërë gabim. Eliminujini këto, zonja Vasilika, se janë turpe. Absolutisht, turp. Çdo njëri merr një funksion politik, e bën atë funksion, kontrollohet për atë funksion që bën. Mund të shkoj më lart, mund të shkojë edhe më keq. Pse ty, zonja Vasilika, nuk të garantohet e drejta që, kur të ikësh nga deputete, nëse nuk të vë lidhshipi i partisë sate, të kthehesh në vendin e punës përsëri? Pse nuk bën një ligj të tillë ti për veten tënde? Unë mendoj se këto duhen hequr. Unë e kam shumë të thjeshtë. Problemi është shumë i thjeshtë. Si e kuptoj unë? Bëjmë një ligj për Inspektoratin e Lartë, domethënë bëjmë një ligj se si do të zgjidhet kryeinspektori, si do të funksionojë kryeinspektori, si do të ecë kryeinspektori, por nuk bëjmë një ligj se ku do të shkojë kryeinspektori, sepse bie ndesh me këtë ligj. Pra, si konkluzion për pikën e parë, mund të jetë me rizgjedhje; për pikën e tretë dua një trajtim më të drejtë se si do të bëhet deklarimi i pasurisë së kryeinspektorit dhe jam kundër paragrafit që kryeinspektori, pasi mbaron 7 vjet apo dy herë nga 7 vjet po ta vëmë në, duhet të kthehet në vendin e punës ku ka qenë.

Faleminderit shumë!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Pyetjet qëndrojnë, sepse duhet sqaruar se cila është logjika e parashikimeve të nenit të shtuar.

Në lidhje me çështjen e pikës 8 që inspektori i Përgjithshëm bën deklarin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij dhe çdo vit, sipas nenit 4 të këtij ligji, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është një gamë zyrtarësh të cilët drejtojnë ose institucione kushtetuese ose institucionet e pavarura të krijuara me ligj. Për efekt të deklarimit

ligji parashikon për secilin zyrtar një institucion përgjegjës ku dorëzohet deklarata, si ne deputetët që e dorëzojmë në Kuvend, si gjyqtarët që e dorëzojnë pranë nëpunësit përkatës në gjykata, si ministri që e dorëzon pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në ministri. Për këta që janë titullarë institucionesh kushtetuese dhe të pavarura, duke qenë se kanë një lloj varësie nga Kuvendi për sa i takon miratimit të buxhetit, strukturës organike dhe të pagave është Kuvendi organi përgjegjës për të mbledhur deklaratat që bëjnë këta zyrtarë. Kontrolli i deklaratave do të bëhet njësoj nga institucioni i deklarimit të pasurive si për zyrtarët e tjerë, por për efekt të pritjes së deklaratës, është Kuvendi ai që e merr në dorëzim këtë deklaratë.

**Bashkim Fino** – Kush e bën?

**Klotilda Bushka** – Deklarimin e bën inspektori i Përgjithshëm, e dorëzon te Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i cili ia përcjell Inspektoratit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kuvendi është thjesht pritës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sapo jua shpjegova. Titullarët e institucioneve kushtetuese dhe të pavarura kanë institucion pritës Kuvendin.

**Bashkim Fino** – Kush e kontrollon?

**Klotilda Bushka** – E kontrollon Inspektorati i Deklarimit të Pasurive.

**Bashkim Fino** – Ka konflikt interesi.

**Klotilda Bushka** – Për pikën 9. Në fakt, është sjellë si një nen i ri ky nen.

*(Ndërhyrje nga zoti Bashkim Fino pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, lëre ta shpjegojë.

**Klotilda Bushka** – Për sa i takon komentit për pikën 9, të drejtën për rrimërimin në funksione në detyrën publike e kishte para zgjedhjes, nëse do ta dëshirojnë këtë gjë, ju vë në dijeni se është një e drejtë e fituar tashmë në ligjin ekzistues. Ky parashikim në ligjin ekzistues është. Duke qenë se neni riformulohet në total që të mos bëhen arna dhe prerje, është bërë teksti integral. Ne nuk mund ta heqim një të drejtë që parashikon ligji aktual.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Bashkim, kemi shtuar një përjashtim që nuk do t'i përfitojë këto të drejta nëse ai ka kryer akte që diskreditojnë rëndë pozitën e tij. Flasim për institucione qëndrueshmëria në detyrë e të cilëve duhet të garantohet. Këto ishin argumentet e mia.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, e para, nuk mora përgjigje pse është me një mandat 7-vjeçar dhe jo me dy, sepse mund ta bënit edhe me dy, me të drejtë rikandidimi, siç janë



institucionet e tjera? Disa i bëjmë me dy, disa i lëmë me një. Kjo nuk shkon, se duhet të mbajmë një standard dhe t'i bëjmë me një mandat të gjitha institucionet. Nuk e kam asnjë problem dhe nuk e kam personale, se nuk do të kandidoj unë. Në qoftë se një guvernatori apo një inspektor tjetër i jepet mundësia të zgjidhet dy herë, pse këtij të mos i jepet mundësia të zgjidhet dy herë? Pra, ka një mandat 7-vjeçar me të drejtë rikandidimi vetëm një herë. Ky është një koment që duhet ta verifikoni për të më dhënë një përgjigje.

E dyta, unë nuk e ngrita çështjen procedurale. Unë u zgjodha kryeinspektor, ku do ta dorëzoi dosjen e pasurisë sime, normal që do të dorëzoi te Kuvendi, sepse ai më zgjedh. Unë ngrita problemin e kontrollit të dosjes sime. Kontrolli i dosjes sime përbën konflikt interesi, po të kthehet përsëri atje, siç tha zonja Klodi, sepse e kontrollojnë varësit e mi. Duke e kontrolluar varësit e mi, ka konflikt interesi. Ata nuk mund të bëjnë një kontroll tamam. Në qoftë se doni ta lini në ligj se dosjen e kryeinspektorit do ta kontrollojë Kuvendi, nëpërmjet Komisionit të Ligjeve mund të ketë një lloj sensi, sepse është niveli i lartë dhe nuk ka lidhje me konfliktin e interesit, me atë që punojnë bashkë. Duhet rregulluar që të jetë i qetë edhe ai. Ti e merr dosjen, e shpie përsëri atje dhe vartësit e mi do ta kontrollojnë.

Për pjesën e fundit jam totalisht kundër, pavarësisht ndërhyrjes shumë dashamirëse që bëri Xhafaj, i cili tha se e kam gabim. Ne diskutojmë për një ligj se si është kryeinspektor, nuk diskutojmë ku do të shkojë kryeinspektor. Pse nuk duhet të ikim ne me idenë se ku do të shkojë kryeinspektor kur të mbarojë; ku do të shkojë X dhe Y kur të mbarojë? Pse ikim me këtë ide ne? Çdo njeri ka dinjitetin dhe CV-në e tij, mbaron atë detyrë për të cilën është zgjedhur nga Kuvendi, mund të kandidojë për një pozicion tjetër. Ti nuk mund t'i thuash që të shkojë në detyrën ku ka qenë më parë. Mua më duket absurde kjo, sepse ai mund të ketë qenë në një punë private apo në një punë shteti dhe mund të ndodhë që t'i jetë suprimuar vendi i punës. Pra, i thua atij që i ka zënë vendin: do të vijë ky, kështu që ti do të ikësh, sepse kështu e kemi vendosur ne në ligjin për kryeinspektorin. Më vjen keq, sepse janë argumente... Ne bëjmë ligj për kryeinspektorin.

Diskutimi im është ky: unë, zotëri, votoj për të gjitha të drejtat dhe se si do të zgjidhet një kryeinspektor i deklaramit të pasurisë, unë nuk do të votoj këtu dhe nuk do të marr përsipër të votoj se, kur i mbaron mandati kryeinspektor, ku do të shkojë. Kjo më duket absurde. Nëse e vëmë në ligjin për kryeinspektorin, ta vëmë në ligj edhe për inspektorët e thjeshtë që t'u garantohet vendi i punës ku kanë qenë të gjithë. Unë jam kundër pikës 9 dhe, ju lutem, merreni në konsideratë këtë që po them, sepse edhe ju vetë e kuptoni që unë kam të drejtë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

E para, zoti Fino, më lejoni t’ju saktësoj në një element lidhur me mandatin 7-vjeçar. Në këtë rast i jepet mundësia, sepse ka qenë e ndaluar. Në draftin e ri i jepet mundësia edhe të rikandidojë, pra është e kundërta, sepse hiqet pa të drejtë rizgjedhjeje.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në pikëpamjen time personale, dhënia e disa garancive për disa institucione, pas përfundimit të detyrës, është fundamentale. Nuk është i vetmi rast ky, por kemi disa institucione kushtetuese, e cila nuk është një punë dosido që duket si një moment kulmor karriere dhe e mbyll, por është një punë e cila sjell përplasje, konflikte reale dhe ku do të punojë nesër ky person kaq i përbaltur dhe i akuzuar shpesh? Atij i jepen garanci që gjatë mandatit të jetë i qetë, ta ushtrojë detyrën e tij me dinjitet në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, por duke ditur që një ditë nuk do të flaket në rrugë dhe nuk do ta pranojë asnjë institucion, sepse ato institucione i ka kontrolluar. Ai do të aplikojë atje dhe mund t’i thonë: “Ky ishte ai që më kontrollonte mua dhe më hapi punë, nuk e pranoj”. Kjo është një e drejtë personale. Ai do të zgjedhë. Nëse do të aplikojë, do t’i respektohet. Ai mund të mos shkojë automatikisht në atë vend pune...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, duhet t’i jepet mundësia që të ketë garancinë që, pas përfundimit të mandatit, të jetë në vendin e mëparshëm, ose në një vend tjetër të barasvlershëm, nëse ai e kërkon. Në këtë ligj kemi futur për herë të parë përjashtimin kur largimi bëhet për efekt disiplinore në moszbatim të ligjit. Ndërsa për sa i takon kërkesës së parë unë mendoj se duhet t’ia lëmë edhe zgjatjen e mandatit, pra është shumë mirë t’i jepet një mundësi kujt do kandidati në një funksion teknik që të ketë të drejtën e rizgjedhjes.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Unë mendoj se duhet ta hedhim në votë, sepse është edhe shqetësimi që ngriti zoti Fino në lidhje me pikën 2. Ne duke bërë një ndryshim te neni 11, pika 2, duke hequr paragrafin pa të drejtë rizgjedhje, ia kemi dhënë mundësinë kryeinspektorit për t’u rizgjedhur, kujt do dhe jo vetëm kryeinspektorit aktual, por edhe KLSH-së ia kemi dhënë mundësinë e rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë. Unë nuk mendoj se duhen shtuar fjalët “Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 7-vjeçar me të drejtë rizgjedhje”, por duke thënë “Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 7-vjeçar” dhe duke hequr paragrafin “pa të drejtë rizgjedhje”. Kështu, ne ia krijojmë këtë mundësi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Misioni EURALIUS ka diçka për të sugjeruar për këtë debat.

**Gianluigi Pratola**– *(përkthen përkthyesi)* Shpreh pëlqimin e EURALIUS dhe mbështetjen e madhe për iniciativën që është ndërmarrë. Për sa i takon nenit specifik, ju duhet ta dini që ne nuk e kemi pasur këtë version të fundit. Këtë nen që po diskutoni nuk e kemi pasur te versioni që ta diskutonim dhe tek raporti që kemi bërë. Gjithsesi, kam një propozim. Faktikisht, në referencë të raporteve të Komisionit të Venecias, që rekomandojnë të krijohen mekanizma të cilët do të lejojnë zhbllokimin e proceseve për emërimin e zyrtarëve, edhe EURALIUS-i është në mbështetje të propozimit për këtë mekanizëm.

EURALIUS-i ka një shqetësimin lidhur me mundësinë për t'i dhënë edhe një mandat të dytë inspektorit të Përgjithshëm, sepse ideja për të qenë 14 vjet në të njëjtin pozicion, për më tepër kaq të rëndësishëm dhe të pushtetshëm, është përqendrimi i fuqisë në një dorë për një kohë të gjatë.

Në anën tjetër, mbështes propozimin që bëhet për pikën 9 të nenit në fjalë për të lejuar mundësinë e kthimit në pozicionin e mëparshëm dhe thotë se për shkak të specifikës që ka kjo detyrë, ky funksion i rëndësishëm, duhet t'i japim disa garanci për t'u rikthyer në pozicionin që ka pasur.

Mënyra më e përshtatshme, për mendimin tonë, për të rregulluar këtë pozicionin është t'i japim mandatin 7-vjeçar, pa të drejtë riemërimi dhe kthimin në pozicionin që ka mbajtur.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Pse kryetari i KLSH-së dhe Guvernatori i Bankës e kanë që zgjidhen për 7 vjet dhe me afat të papërcaktuar? Pra, mund të kandidojnë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pse për kryeinspektorin thoni boll janë 7 vjet dhe jo pa limit? Ose do të kemi një trajtim të njëjtë në ligj, sepse ne i bëjmë ligjet, jo EURALIUS-i, se nuk është korrekte që KLSH-ja dhe Guvernatori i Bankës ta kenë mandatin 7 vjet e pa limit, ndërsa këtë ta vëmë 7 vjet e me limit, e para.

E dyta, kam edhe një pyetje për kuriozitet. Pasi të ikë ky nga inspektimi, a e ka të garantuar vendin e punës? Do të shkojë prapë te vendi i punës ku ka qenë?

*(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka përgjigje?

**Bashkim Fino** – Jam kundër.

**Ulsi Manja** – Jo, mor, jo!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Atëherë, zoti Fino është kundër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Hedhim në votim nenin 6, sipas variantit të propozuar nga nismëtarja dhe relatorja, pra sipas tekstit integral.

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Çfarë të të kthej përgjigje?!

Opinionin e EURALIUS...

Kujt ia adreson pyetjen?

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Dakord.

**Bashkim Fino** – Pse kryetarit të KLSH-së ia vë mandatin 7 vjet e pa limit, ndërsa...?

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A keni propozim konkret?

**Bashkim Fino** – Kam, si jo.

**Ulsi Manja** – Bëjeni propozimin konkret dhe ta hedhim në votë.

**Bashkim Fino** – Unë kërkoj mirëkuptimin tuaj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...që ligjet të jenë uniform, siç janë edhe ligjet e tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, se po bëj një propozim tejet interesant dhe ti e kupton këtë gjë. Mos bëj kot tani rolin e budallait!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë po them që kryetarin e KLSH-së, Guvernatorin e Bankës i ke në ligj sot. E kemi miratuar edhe unë, edhe ti kemi ngritur dorën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Një mandat është.

**Bashkim Fino** – Jo, jo, të lutem, është mandat shtatëvjeçar pa limit!

Atëherë, kryeinspektorin pse nuk e vë me mandat shtatëvjeçar, edhe këtë pa limit, e të jemi në rregull?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si të tria këto institucionet e tjera.

Dy institucionet e tjera i ke kështu, ndërsa këtij i thua: jo, shtatë vjet dhe ik. Pse? Sepse janë shumë katër vjet. Çfarë është kjo? Kjo është absurde. Ligjet i bëjmë ne, jo ata.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Këtë po them edhe unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mbarova, edhe dy fjali.

Propozimi im është ta hapë këshilltarja e komisionit si e ka zgjedhjen e kryetarit të KLSH-së dhe Guvernatorit të Bankës, ashtu vjen edhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pse flet ti?

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Zoti Fino, neni 162/2 i Kushtetutës thotë: “Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për shtatë vjet me të drejtë rizgjedhjeje”.

**Bashkim Fino** – Është Kushtetuta kjo.

**Ulsi Manja** – Po pra, Kushtetuta. Këtë kemi thënë edhe ne me nenin 6.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Po e heqim shprehjen “pa të drejtë rizgjedhjeje”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Po e heqim “pa të drejtë rizgjedhjeje”.

*(Debat në sallë)*

Kush është dakord me nenin 6, sipas variantit që propozohet?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kundër? Abstenim?

**Spartak Braho** – Unë jam me propozimin e zotit Fino.

**Ulsi Manja** – Zoti Braho, më duket se nuk e keni kuptuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino po thotë pikërisht këtë që kemi në ligj, këtë që po propozojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

A ka mundësi të merremi vesh, sepse nuk po merremi vesh?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 11 i ligjit ekzistues thotë: “Inspektori i përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë për një mandat shtatëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhje”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne themi: “Inspektori i përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë për një mandat shtatëvjeçar”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, hiqen fjalët “pa të drejtë rizgjedhje”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, mor, çfarë interpretimi, është në vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë: në do ta rizgjedhë, e rizgjedh; nëse jo, nuk e rizgjedh!

*(Diskutime në sallë njëkohësisht)*

Hedhim në votim...

*(Deputetët Fino, Çuçi e të tjerë flasin njëzëri pa mikrofon.)*

Zoti Çuçi, a ka mundësi?

**Bashkim Fino** – Në pikën 2 të këtij neni ti thua: “Inspektori i përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë për një mandat shtatëvjeçar”.

**Bledar Çuçi** – Po.

**Bashkim Fino** – Ma gjej një nen tjetër që të ketë një mandat shtatëvjeçar. Ma thuaj në cilin nen ta lexoj? Ndërkohë, më lexon pikën 7, ku thuhet: “Kuvendi zgjedh inspektorin e përgjithshëm me tre të pestat e anëtarëve të tij në votimin e parë. Nëse rast se kjo shumicë votash nuk arrihet”, kjo është tjetër gjë “Kuvendi zhvillon një votim të dytë pas 7 ditësh me shumicë votash. Kaq. Por kjo nuk thotë edhe për një mandat të dytë. Kjo tregon...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, a ka mundësi?

Fjalën e fundit e ka zoti Çuçi për një koment.

*(Diskutime në sallë)*

Ju lutem!

Do ta hedhim në votim pas fjalës së zotit Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Faleminderit, zoti kryetar!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po bëjmë debat për një gjë për të cilën jemi të gjithë dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjëja e parë për të cilën jemi dakord është që kufizimin që ka ligji aktual sot për të mos e lejuar të zgjidhet për një mandat të dytë, ne do ta heqim.

*(Diskutime në sallë)*

Jemi dakord të gjithë për këtë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është fjalia...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Biem dakord në parim? Nuk ka rëndësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, në parim jemi dakord që ta heqim. Çështja është te formulimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino tha se nuk e kënaq fjalia, që ne thjesht heqim fjalët “pa të drejtë rizgjedhje”.

*(Diskutime në sallë)*

Tani, ne kemi shumë institucione kushtetuese, duke filluar nga Kryeministri, por nuk thuhet që Kryeministri apo qeveria ka një mandat, që parlamenti ka një mandat, që deputeti ka një mandat kaq vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo nuk thuhet askund.

Kufizimi është përjashtim nga rregulli. Sakaq, rregulli është vazhdimësia e institucionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E fundit, edhe kryetarët e bashkive...

Zoti Fino, më dëgjoni!

*(Diskutime në sallë)*

**Ulsi Manja** – Zoti Çuçi, ju lutem, përmbylleni fjalën!

**Bledar Çuçi** – ...para se ne të ndryshonim ligjin për kufizimin deri në tre mandate të kryetarëve të bashkive, ka qenë pa kufizim dhe nuk shprehej fare, pra nuk shprehej se mandati i një kryetari bashkie është një herë trevjeçar, pastaj katërvjeçar. Domethënë, nuk shprehej “me të drejtë rizgjedhjeje” ose “pa të drejtë rizgjedhjeje”. Ndërkohë, ne vëmë kufizime dhe shprehemi në ligj “me të drejtë një herë, dy herë ose tri herë rizgjedhjeje”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Propozimi është shumë i qartë, madje e kënaq të gjithë konsensusin që kemi për çështjen. Kjo është e gjitha.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Çuçi!

Hedhim në votim nenin 6, sipas variantit të propozuar dhe tekstit integral nga relatori. Kush është dakord? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vazhdojmë me nenin 7.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fiksohet.

**Elena Xhina** – Jam shumë kundër.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, me mikrofon!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elena Xhina** – ...vetëm një mandat shtatëvjeçar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elena Xhina** – Por me këtë formulim lihet mundësia...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Do të sqarohet më mbrapa.

*(Debat në sallë)*

Vazhdojmë me nenin 7.

*(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)*

A ka mundësi pak qetësi në komision?

Këtu jemi të gjithë juristë dhe nuk besoj se ky është ligji i parë që kalon në këtë komision.

**Adnor Shameti** – Me përjashtim të zotit Fino.

**Ulsi Manja** – Më duket se një jurist i këtij komisioni ka tre mendje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Hyseni!

A ka mundësi pak qetësi në komision?

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Vendosni pak qetësi.



**Bashkim Fino** – ...do të votoj siç duhet.

Kur të iki, vendos ti, si jurist.

**Ulsi Manja** – Neni 7. Kush është dakord me nenin 7, sipas variantit që propozohet?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, ka një ndryshim në nenin 15. Hiqet vetëm referenca, numri i ligjit, ku thuhet: “Legjislacioni në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Nenet 7, 8 apo 9 do t’i shikojmë në vijim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, në nenin 15 të ligjit ekzistues nuk ka ndryshim përmbajtjeje, vetëm hiqet referenca te numri i ligjit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Hedhim në votim nenin 7.

*(Deputetët Braho dhe Shameti flasin pa mikrofon.)*

**Vasilika Hysi** – I njëjti formulim siç e ka ligji.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 7, sipas variantit që propozohet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8, që ndryshon nenin 17.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Është e njëjta gjë, nuk ka ndryshim të përmbajtjes së nenit, por vetëm hiqet numri i ligjit të cilit i referohemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 8, sipas relatores? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, që ndryshon nenin 25/1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10, që ndryshon paragrafin e katërt të nenit 26. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11, që ndryshon pikën 3 të nenit 40, sipas tekstit...

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12, që ndryshon nenin 42/1.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Bashkë me zonjën Xhina sugjerojmë që formulime të tilla, deri në momentin e funksionimit të sistemit elektronik e të tjerë, nuk kanë vend në një dispozitë të tillë, por duhen vendosur në dispozitat kalimtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Se ligjin nuk e kemi përpara.

**Ulsi Manja** – Në ligjin ekzistues është dispozitë kalimtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Elena Xhina** – Janë kalimtare të dyja.

**Klotilda Bushka** – Elena, e kemi te kolona e parë e tabelës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Alket Hyseni** – Tërhiqemi.

**Ulsi Manja** – Në rregull.

Kush është dakord me nenin 12, sipas variantit të relatores? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Kalojmë te neni 13, që ndryshon nenin 42/1: “Shtohet neni 42/2 me përmbajtjen si më poshtë”. Kush është dakord me nenin 13, sipas variantit integral? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Kalojmë te neni 14. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Hyrja në fuqi” e ligjit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

*(Diskutime në sallë)*

Ju lutem, zonja Xhina, jemi në votimin në tërësi!

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”, nismë e deputetes Klotilda Bushka.

Shumë faleminderit!

Me miratimin në tërësi të këtij projektligji, e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit, së bashku me rendin e ditës.

Faleminderit përfaqësuesve të Inspektoratit!

Faleminderit përfaqësuesve të misionit EURALIUS!

Faleminderit kolegëve dhe të pranishmëve!

**MBYLLET MBLEDHJA**